



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission

27 -12- 2019

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), neni 37.3, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 27.12.2019, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **ZNJ. MARIJA BOGOSAVLJEVIĆ** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut, nga subjekti politik "SRPSKA LISTA" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Jasmina Dedić.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Marija Bogosavljevic dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 26.12.2019, Nr.2007/2019, për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit Komunal znj. Jasmina Dedić pas dorëheqjes së saj të parevokueshme nga pozita e anëtares së Kuvendit të Komunës, për arsye të zgjedhjes deputete në Kuvendin e Kosovës, nga zgjedhjet e mbajtura më 6 tetor 2019.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidat i radhës në listën e rirenditur është znj. Marija Bogosavljević, e cila ka dhënë deklaratën e pranimin të mandatit si kandidate e radhës, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 27.12.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka